



SHËRBESA E PRËHJES

PËR TË VDEKURIN

Kur vdes nonjë, thirret PRIFTI më shtëpi dhe, si vë Petrahilë dhe temian më temianicën, nis :

E bekuar është Perëndia jonë për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen.

Shënt Perëndî, Shënt i Fuqishmë, Shënt i Pavdekur, mëshirô-na. (Tri herë.)

Lavdî Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt; tanî e përherë e në jetë të jetëve. Amen.

Trinî e Tërëshëntë, mëshirô-na. O Zot, hirësoj-i mëkatat tona. O Zot i Math, ndjej i paudhësitë tona; O i Shëntë, vështroj i dhe shëroj-i sëmundjet tona për emërin tënt.

Mëshirô, ô Zot. (Tri herë.) Lavdî; Tanî.

Ati ynë që je ndë qiell, u-shëntëroftë emëri yt; arthte mbretëria jote; u-bëftë dëshira jote si ndë qiell edhe mbi dhë; bukën tonë të përditëshme epna-e neve sot edhe fal-na-i fajet, sikundër edhe neve u' a falim fajtorëve tanë; dhe mos na shtier ndë ngasje, po shpëtô-na nga i ligu.

PRIFTI :

Se jotja është mbretëria, edhe fuqia, edhe lavdia,

e Atit, e Birit, dhe e Shpirtit Shënt, tanî e përherë,
e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen.

Pastaj këtë Tropicë :

TINGËLL IV.

Bashkë me shpirtet e të drejtëve të mbaruar,
prëh-e, ô Shpëtimtar, shpirtin e shërbëtorit tënt, dhe
ruaj-e te jeta e lumur që është pranë teje, ô njerzi-
dashës.

Te prëhja jote, ku prëhen gjithë Shëntorët tënt,
prëh-e dhe shpirtin e shërbëtorit tënt, se ti je vetëm
i pavdekur.

LAVDË.

Ti je Perëndia që zbritë në Ferr, dhe zgjidhe
dhëmbjet e të lidhurve ; ti pra, ô Shpëtimtar, prëh-e
dhe shpirtin e shërbëtorit tënt.

TANË.

O Virgjëreshë e vetëm e kulluar dhe e pa-pikluar,
që linte Perëndî pa-farë, nërmjetô që të shpëtohet
shpirt' i shërbëtorit tënt.

PRIFTI :

Mëshirô-na, ô Perëndî, pas mëshirës s' ate së
madhe, të lutemi, dëgjô e Mëshirô.

VALLEJA

Mëshirô, ô Zot. (Tri herë.)

Të lutemi dhe për prëhjen e shpirtit të shërbëtorit të Perëndisë të fietur (aksh), dhe që t' i falet ç' dô faj i dashur a i padashur.

Që t' a vëndosë Zoti Perëndia shpirtin e tij, atjê tek prëhen të drejtët. Mëshirat e Perëndisë, Mbretërin' e qiejve, dhe ndjesë të mëkatëve të tij, Krishtit Perëndisë dhe Mbretit tonë të pavdekur le t' i lypim.

VALLEJA :

Fal-i, ô Zot.

PRIFTI :

Le t' i lutemi Zotit.

O Perëndi e shpirteve dhe e ç' dô mishi, që shkele vdekjen, abolite Diallin, dhe i dhurove botës jetën ; ti, ô Zot, prëh-e shpirtin e shërbëtorit tënt të fietur (aksh) në vënt të ndriçim, në vënt të lëndinëshim, në vënt rîfreshkimi, ngahaka ikur ç' do dhëmbje, hidhërim dhe psherëtim ; ç' dô mëkatë që ka bërë me fialë, a me punë, a me mëndje, fal-i' a si Perëndi e mirë dhe njerzidashëse ; se s' ka njeri që të rrojë dhe të mos bierë në mëkatë ; se ti je vetëm pa-mëkatë ; drejtësia jote është drejtësi më jetët dhe fiala jote është e vërteta.

Se ti je ngjallja, jeta, dhe prëhja e shërbëtorit tënt të fietur (aksh), ô Krisht Perëndia jonë, dhe ty të dërgojmë lavdi, bashkë me Atin tënt pa-nisje, dhe me Shpirtin tënt tërëshënt, të mirë, e jetëdhënës, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

LAVDI; TANI.
PËRLËSHIM.

Dhe bekon përsëri dhe nisin të këndojnë nga-dale « Shënt Perëndi. » Dhe e ngrenë lipsanë dhe e shpien në Kishë. Priftëria venë përpara dhe Diaku pas me Temianicën. Kur hyjnë në Kishë, e vënë lipsanë në mest dhe nisin thonë Psalmin :

PSALM 91.

Kush rri nën mbulesën e të Lartit, do të ketë të ndënjurit nën hie të Fuqimadhit. I kam për të thënë Zotit: Ti je mpshtetja ime, e kështjella ime, ô Perëndia ime; dhe m'atë kam për të shpëryer. Se ay do t' të shpëtojë prej kurthit të gjahtorit, prej murtajës së zezë. Do t' të mbulojë me pëndët e tija, e do t' përikësh nën fletët e tij; e vërteta e tij është shqyt edhe mburonjë. Nuk do t' frikësohesh prej tmerrit të natës, as prej shigjetës që hidhet ditën; as prej murtajës që ecën n' errësirë, as prej dështrojtjes që shkretton në mest të ditës. Një mijë do të bien përënë teje, e dhjetë mijë së-diathti teje; po ty do t' mos t' afrohet. Veç me syt' e tû do t' shëkosh, e do t' shohësh çpagimin e fajtorëve. Se ti, ô Zot, je shpresa ime; të Lartin më ke bërë vënt për të ndënjur. Nuk do t' t' avitet nonjë e keqe, edhe frushkullë nuk do t' afrohet në tendën tënde. Se do t' urdhërojë ëngjëjt e tij për ty që të ruajnë ndë gjithë udhët e tua. Do t' të ngrenë mi duar, që të mos përpieksh këmbën tënde më gur. Do të bareç mi luan e mi aspikë, e do t' përshkelësh këlysh luani dhe dragua. Se shtiu dashurinë mbi mua, përandaj

do t' a çliroj ; do t' a lartësoj se njohu emërin t'im.
Do t' më përthërresë e do t'a dëgjoj ; do t' i jem
pranë në shtrëngim ; do t' a shpëtoj e do t' a lavdë-
roj. Do t' a nginj me ditë të gjata, e do t' i dëftoj
shpëtimin t' im.

Pastaj këndohen këtë me zë të fortë :

STANCË I. TINGËLL TËRTHOR II.

Faqebardhët mbë udhë. Alleluia. I bekuar je, ô
Zot, mësô-më të drejtat tënde. Alleluia.

Shpirti im dëshëron për mallë që kam për gjyqet
e tû përherë. Alleluia.

Shpirti im po kullon prej hidhërimit ; forcô-më
pas fialës s' ate. Alleluia.

Unj zëmëren t' ime nër dëshmimet e tua dhe mos
ndë lakmim. Alleluia.

M' u-ndes zëmërimi për mëkatarët që kanë hequr
dorë prej ligjës s' ate. Alleluia.

Unë jam shok i gjithë atyre që të kanë frikë e
ruajnë porosit' e tua. Alleluia.

Lavdî Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt.

Tani e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Alleluia.

STANCË II. TINGËLL TËRTHOR I.

Duartë tënde më bënë e më gatuan ; bë-më të mën-
çim, edhe do t' mësoj urdhërimet tënde. Mëshiroj-e
shërbëtorin tënt.

Sepse u-bëra posi shakulli në t'ym ; po nukë har-

rova urdhërimet e tua. Mëshiroj-e shërbëtorin tënt.

Yti jam unë, shpëtô-më, se kërkova porosit' e tua. Mëshiroj-e shërbëtorin tënt.

Nukë dolla jashtë nga gjyqet e tû, se ti më mësove. Mëshiroj-e shërbëtorin tënt.

Unja zëmërën t' ime për të bërë urdhëret e tû përherë gjer në funt. Mëshiroj-e shërbëtorin tënt.

Eshtë kohë t' i shërbejmë Zotit, se e prishnë ligjën tënde. Mëshiroj-e shërbëtorin tënt.

Lavdî, Tanî. Mëshiroj-e shërbëtorin tënt.

STANCË III. TINGËLL III.

Shtjer sytë mbi mua edhe mëshirô-më, pas gjyqit që u bën atyre që duan emërin tënt. Alleluia.

Jam i ri dhe i pazënë për gjë ; po nuk harrova porosit' e tua. Alleluia.

Dëgjoj-e zënë t' im, ô Zot, pas mëshirës s' ate, dhe ngjall-më pas gjyqit tënt. Alleluia.

Të parët më kanë ndiekur më kot, po zëmërën t' ime e mori frika për fialën tënde. Alleluia.

Rroftë shpirti im, dhe do t' të lavdërojë, edhe gjyqet e tû më ndihçin. Alleluia.

U-arratisa posi dele e humbur ; kërkuj-e shërbëtorin tënt, se nuk i harrova urdhërimet tënde. Alleluia.

Dhe me një herë thohen këtë :

TINGËLL TËRTHOR I.

I bekuar je, ô Zot, mësô-më të drejtat tënde.

Shoqëri ' e Shëntorëve gjeti burimin e jetës dhe derën e Parrajsës; do t' a gjej dhe unë udhën me anën e pendimit; unë jam deleja e humbur; thirr-më prapë, ô Shpëtimtar, dhe shpëtô-më.

I bekuar....

Ti, që më gatove që-moti nga e mos-qëna, dhe më nderove me korën tënde të perëndishme, dhe më ktheve prapë te dheu, prej të cilit më more, nga baritja e porosisë, sill-më prapë te shëmbëllsia jote, dhe përllint-m'a bukurin' e motshime.

I bekuar....

Jam kora e lavdisë s' ate së patreguar, me-gjith'që kam pikla prej fajesh; mëshirôj-e kriaturën tënde, ô Zot, dhe spastroj-e me dhëmpshërinë tëndë; dhe fa-m' a atdhen' e përmallshim, duke më bërë përsëri qytetar të Parrajsës.

I bekuar....

Prëh-e, ô Perëndi, shërbëtorin tënt, dhe vëndos-e në Parrajsë, ku shoqërit' e Shëntorëve, ô Zot, dhe të drejtët shkëlqejnë si yj; prëh-e shërbëtorin tënt të fietur, duke mos vënë-'re tërë krimërat e tij.

Lavdi. TRINISORE.

Tri-shkëlqimin e Hynisë së njëshme, le t' a hym-nojmë besërisht duke thirrur: I shëntë je, ô At' i panisjeshim, ô Bir i bashkëpanisjeshim, dhe Shpirt' i perëndishmë; ndriçô-na ne që t' adhurojmë me besë, dhe rrëmbê-na prej ziarrit të përjetëshm.

Tanî. HYJLINDËSORE.

Gëzoh-u, ô e nderuar, që linde Perëndinë mishë-

risht për shpëtimin e të gjithëve ; me anën tënde gjindja e njerësve gjeti shpëtimin ; me anën tënde gjeçim Parrajsën, ô Hyjlindëse, e kulluar dhe e bekuar.

Alleluia, alleluia, alleluia. Lavdî ty, ô Perëndî.
(Për-së-treti.)

Pastaj thohet kanuni me këtë Shkurtore.

TINGËLL TËRTHOR IV.

Bashkë me Shëntorët prëh-e, ô Krisht, shpirtin e shërbëtorit tënt, atiê tek nukë ka as dhëmbje, as helme, as psherëtim, po vetëm jetë të pambaruar.

Pastaj këtë të Vetëzëshme të JOAN DAMASHKARIT.

TINGËLL I.

Cili gëzim i jetës mbetet i papërzier me hidhërim? cila lavdî qëndron mbi dhê e paçvëndosur? të gjitha janë më të dobëta se hieja, të gjitha janë më të rreme se ëndërrat ; një çast e të gjitha këtë i nëkëmbëson vdekja. Po te drit' e faqes s' ate, dhe te ëmbëlsir' e bukurisë s' ate, ô Krisht, prëh-e atë që zgjodhe, si njerzidashës.

TINGËLL II.

Si lule fishket, dhe si ëndërr shkon, e përndalet ç' dô njerî ; dhe prapë, kur të oshëtijë trumpeta, gjithë të vdekurit, si më një bashkëtronditje, do të ngrihen që të të dalin përpara, ô Krisht Perëndî ; atëhere, ô Zoti Krisht, vëndos-e shpirtin e shërbëtorit tënt që e more prej nesh nër tendat e shëntorëve tënt.

TINGËLL III.

Kotësira janë gjithë të njerëzishmet që s' qëndrojnë pas vdekjes ; nukë mbetet pasuria, nukë vete pas lavdia ; se vien vdekja, dhe këtë të gjitha përpihen ; përandaj le t' i thërresim Krishtit, mbretit të pavdekur : Prëh-e atë që shkoj prej nesh atië tek është ndënja e gjithë të dëfryerve.

TINGËLL IV.

Me të vërtetë është fort i trëmpshim mister' i vdekjes ; si ndahet me pahir shpirti prej harmonisë së trupit, dhe pritet me vullnet të perëndishmë legëtyra e natyrëshme e bashkëqënjes. Përandaj të lutemi : Prëh-e të jetë-ndërruarin nër tendat e të Drejtëve tënt, ô Jetëdhënës njerzidashës.

TINGËLL TËRTHOR I.

Kujtova Profetin që thërriste : Unë jam dhë e hí ; dhe hodha synë prapë nër varret, dhe pashë eshtërat e çveshura, e thashë : Kush është atëhere mbret, a ushtar, a i pasur, a i varfër, a i drejtë, a mëkatar ? Po prëh-e, ô Zot, shërbëtorin tënt bashkë me të drejtët.

TINGËLL TËRTHOR II.

Urdhëri yt kriesor ka qënë krej' i im dhe qënja ime ; se të pëlqeu të më formosh një kriaturë të gjallë prej natyre të dukur e të padukur, dhe m' a përgatove trupin prej dheut dhe më ke dhënë shpirt

me frymën tënde të perëndishme dhe jetëdhënëse. Përandaj, ô Krisht, prëh-e shërbëtorin tënt në vënt të gjallësh e nër tenda të drejtësh.

TINGËLL I RËNDË.

O Jetëdhënës, Shpëtimtari ynë, prëh-e vëllanë tonë që e ngrite nga jeta e përkohëshme dhe që thërret : Lavdî më ty.

TINGËLL TËRTHOR IV.

Qaj e vajtoj, kur shkoj ndër mënt vdekjen dhe shoh bukurinë tonë të gatuar pas korës së Perëndisë të shtrirë në varr të çfytuar, të palavdishim, pa formë. O çudî ! ç' është ky myster rreth nesh ? Si qënkemi të përdhënë te prishja dhe si qënkemi të marrtuar me vdekjen ? Me të vërtetë, siç është shkruar, pas urdhërit të Perëndisë, i cili i fal prëhjen të jetë-ndërruarit.

Pastaj Lumërimet dhe pas atyre :

APOSTULLI.

Qoft' e lumur udha që po baret ti sot, se të është përgatitur vënd' i prëhjes. Te ty, ô Zot Perëndia ime thirra.

Këndimi prej Letrës së Parë të Palit nër Thësalonikasit :

Vëllezër, nukë dua të mos dini për të fieturit që të mos hidhërohi si dhe të tierët që s' kanë nonjë shpresë. Se, në besojmë se Krishti vdiq e u-ngjall,

ashtu dhe Perëndia me anën e Jesujt do t' i shpierë të vdekurit bashkë me veten e tij. Se këtë e thomi pas fjalës së Zotit, që ne të gjallët që do të mbetemi gjer më ardhjen e Zotit, nuk do t' i arrijmë të futurit ; se vetë Zoti me urdhërim, me zë krye-ëngjëlli, dhe me trumpetë Perëndie, do të zbresë prej qiellit, dhe të vdekurit do të ngjallen të parët më emërin e Krishtit ; pastaj ne të gjallët të mbeturit, do të rrëmbehemi bashkë me tâ nër retë që të piekim Zotin në erë ; dhe ashtu do të jemi bashkë me Zotin ngaherë.

Alleluia. Lum' ay që zgjodhe dhe e more, ô Zot.

UNGGJILLI (PAS JOANIT).

Tha Zoti nër Judejtë që i kishin ardhur. Me të vërtetë, me të vërtetë po ju thom që, ay që dëgjon fjalën t' ime, dhe beson atë që më dërgoj, ka jetë t' ameshuar ; dhe nukë vien më gjyq, po shkon prej vdekjes te jeta. Me të vërtetë, me të vërtetë po ju thom, se vien ora, dhe tanî është, që të vdekurit do t' dëgjojnë zërin e Birit të Perëndisë dhe atâ që do t' dëgjojnë do të rrojnë. Se, sikundër Ati ka jetë më vete, ashtu i dha dhe Birit të ketë jetë më vete. Dhe i dha pushtet dhe për të bërë gjyq ; se është bir njeriu ; mos u-çuditni për këtë ; se vien ora, më të cilën gjith' atâ që janë nër varret do t' dëgjojnë zërin e tij ; dhe do të venë atâ që bënë të mira më ngjallje jete ; dhe atâ që bënë të këqia më ngjallje gjykimi. Nukë munt unë të bëj gjësendi prej

vetes s' ime ; sikundër dëgjoj, gjykoj ; dhe gjykimi im është i drejtë ; se nuk kërkoj dëshirën t' ime, po dëshirën e Atit që më dërgoj.

DIAKU :

Mëshirô-na ô Perëndi...

Të lutemi dhe për prëhjen e shpirtit...

Dhe si mbarohet kiô, i Par' i Priftërve, a Kryepifti, thotë Urimin : « O Perëndi e shpirtëve dhe e ç' dô mishi... » pranë lipsanit.

Pastaj me zë të lartë :

Se ti je ngjallja, jeta dhe prëhja...

Pasandaj bëhet përshëndoshja e fundit dhe këndohen këtë Vargësore të Përshëmbëllta.

TINGËLL II.

Pas : « Ote ek tu ksylu ».

Eni t' i apim të vdekurit përshëndoshjen e fundit, ô vëllezër, duke përhiruar Zotin ; se ky u-nda nga gjirij' e tij, dhe nxitohet për në varr, dhe s' përkujdeset më për kotësiat dhe mishin e mundimshim ; ku janë tanî gjirinjtë dhe miqtë ? tanî po ndahemi nga ky, për të cilin le të lutemi t'a prëhë Zoti.

Ç' është kiô ndarje, ô vëllezër ? ç' është kiô qarje, e ky vajtim më çastin e tanishmë ; eni pra të përshëndoshni atë që ish pak më parë me ne ; se përipet në varr, mbulohet me gur, vëndoset më t' errët, varroset bashkë me të vdekurit : të gjithë gjirinj e

miq, taní po ndahemi nga ky, për të cilin le të lutemi t' a prëhë Zoti.

Taní përndahet gjithë panair' i prapë i kotësisë së jetës ; se shpirti shkoj nga tendësimi ; balta është nxirë, ena u-ça, pa-zë, pa-ndienjë, e vdekur, e palëvizur, të cilin duke e përciellë më varr, le t' i lutemi Zotit t' i apë prëhjen më jetët.

Si është kiô jeta jonë? si lule, si avull, si ves' e mëngjezit me të vërtetë : Eni pra të hedhim një sy mi varret me gjithë fuqi ; ku është bukuri' e trupit ? ku është risia ? ku janë sytë dhe forma e mishit ? të gjitha u-fishknë si bar, të gjitha u-venitnë ; eni pra t' i biem Krishtit nër këmbë me lot.

Qarje e madhe dhe vajtim, psherëtim i math, dhe shtrëngim është ndarja e shpirtit ; Ferr dhe humbje është jeta e përkohëshme, hieja e paqënë, gjum' i rrejtjes, mundimi i kottë i jetës së dheut, le të i-kim lark ç' do mëkate të botës, që të trashëgojmë lumëritë qiellore.

HYJLINDËSORE.

Shpëtô atâ që shpresojnë më ty, ô Mëm' e Diellit të paperënduar Hyjlindëse ; lutni Fortmirit t' a prëhë me nërmjetimet e tua atë që ndrroj jetë taní atië tek prëhen shpirtet e të Drejtëve ; rrëfej-e trashëgimtar të të mirave të perëndishme nër hoboret e të Drejtëve, për kujtim të përjetëshm, ô e kulluar.

Lavdí. TINGËLL TRËTHOR II.

Duke më parë të shtrirë pa-zë e pa-frymë, përpara jush, qani të gjithë mbi mua, ô vëllezër dhe miq,

gjirinj e të njohur ; se ditën e dieshme bashkë me ju po flisja, dhe me një herë më erdhi mi krye ora e vdekjes. Po eni të gjithë atâ që më kini mall, dhe përshëndoshmëni përshëndoshjen e fundit; se do t' mos bares më bashkë me ju, as që do të flasim bashkë që tanî e tutje ; se shkoj te gjykatësi, ku s' ka hatër ; se robi dhe zoti qëndrojnë bashkë përpara, mbreti dhe ushtari, i pasuri dhe i varfëri më një radhë ; se cilido pas punët e tij, a do t' lavdërohet, a do t' turpërohet : Po ju lyp të gjithëve dhe ju lutem, pa pushuar t' i luti për mua Krishtit Perëndisë, që të mos vëndosem pas mëkatave të mia te vënd' i mundimit, po të më vëndosë atië ku është drit' e jetës.

Tanî. HYJLINDËSORE.

Me nërmjetimet e asaj që të lindi, ô Krisht, dhe të Parërendësit tënt, t' Apostujve, të Profetëve, të Kryepriftërve, t' Oshënarëve, të Drejtëve, dhe të gjithë Shëntorëve, prëh-e shërbëtorin tënt të fietur.

Pastaj PËRLËSHIMI :

Krishti, Perëndia jonë e vërtetë, që u-ngjall së vdekurësh, me nërmjetimet e Zonjës s' onë Hyjlin-dëse Shën-Mari, t' Apostujve të shëntë, të lavdëruar dhe emër-shkëlqyer, t' Atërve tanë oshënarë dhe hyjprurës, dhe të gjithë shëntorëve, e vëndostë shpirtin e shërbëtorit të tij të jetëndërruar më tenda të Drejtësh, e prëhtë nër gjinjët e Abraamit, dhe e

nëmëroftë bashkë me të drejtët, dhe neve na mëshiroftë, si i mirë dhe njerzidashës.

I përjetëshm qoftë kujtimi yt, ô vëllai ynë i lumëruarshim dhe i përkujtuarshim. (Tri herë).

Pastaj e ngrenë lipsanë dhe shkojnë në varret, duke kënduar « Shënt Perëndi ».

Kur vihet lipsani në varr, PRIFTI merr dhë me lopatën dhe e heth mi lipsanë kryqthi, duke thënë :

I Zotit është dheu dhe rrafshëri' e tij, gjithësia, dhe gjith' atâ që rrinë mi të.

Pastaj derth vaj dhe verë, a hin' e Temianicës. Pastaj e mbulojnë, duke kënduar pas zakonis Troparet « Bashkë me shpirtet e të Drejtëve... » dhe Përlëshim.

Lavdi Perëndisë që urdhëroj kështu.

Duhet ditur që kiô Shërbesë bëhet dhe për gratë e për diemt' e Orthodoxëve, veç që ndërrohet emëri më femër a më mashkull.